

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DHËNIE AMNISTIE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji është hartuar në funksion të arritjes së qëllimit të dënimit, bazuar në të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të individit, arritjes së riintegritimit dhe të rehabilitimit social, ndyshimeve pozitive në jetën e të dënuarve, si dhe trajtimin e tyre sipas standardeve evropiane në sistemin penitenciar.

Në këtë kuadër, qëllimi i nismës konsiston në amnistinë e dënimit, e cila ndërhyr pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e tij.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Është përsëritur vazhdimisht se amnistia është një masë e tillë nëpërmjet së cilës shteti “heq dorë” nga zbatimi i dënimit për vepra penale të caktuara. Bëhet fjalë për një masë me një natyrë të përgjithshme që çmohet të jepet dhe inspirohet për shkaqe të paqimit social dhe, që, mbi të gjitha, ka në fokus dinjitetin njerëzor dhe lirinë e individit.

Amnistia është ajo që sot identifikojmë si një zgjidhje tjetër, për të arritur te një drejtësi të tillë që të mbrojë mbi të gjitha jetën, lirinë dhe dinjitetin njerëzor, për ata që kanë kryer një vepër penale.

Përpos sa më sipër, aplikimi i amnistisë duhet vlerësuar edhe në raport me sistemin e dënimeve, në thelb të të cilit funksionon parimi se sanksionet penale si “*ultima ratio*”, duhet të udhëhiqen nga parimet kushtetuese dhe funksionet që i karakterizojnë ato, përkatësisht ai edukativ (funksioni i parandalimit të

përgjithshëm të veprave penale) dhe ai i parandalimit të posaçëm (që lidhet me riedukimin e autorit të veprës penale).

Në këto kushte, aplikimi i amnistisë, përveçse ndikon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e kushteve në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale (pavarësisht se kjo nuk është nxitja kryesore e ndërmarrjes së kësaj nisme), është një akt i cili shpreh vullnetin shtetëror për të rivendosur dinjitetin e të dënuarve.

Projektligji përjashton nga fusha e tij e zbatimit kategoritë e veprave penale që parashikojnë rrezikshmëri të lartë shoqërore ose të dënuarit që paraqesin rrezikshmëri të theksuar.

Konkretisht, janë përjashtuar veprat penale që kanë të bëjnë me:

- fushën e krimeve kundër njerëzimit;
- krimet e rënda kundër jetës, të kryera me dashje;
- veprat penale kundër shëndetit;
- krimin e organizuar;
- veprat penale që lidhen me lirinë e personit;
- veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, që kanë një rrezikshmëri të lartë;
- veprat penale kundër fëmijëve, martesës, ku përfshihet keqtrajtimi i tyre, dhuna në familje, përdorimi i fëmijëve dhe shtytja e tyre në krim, pra vepra penale të cilat janë të rënda dhe cenojnë interesin e fëmijëve dhe të familjes.

Gjithashtu, nuk përfitojnë për shkak amnistie, subjektet e dënuara për disa lloje të caktuara veprash penale, kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit, veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, kundër mjedisit, pavarësisht dhe rendit kushtetues apo vepra të tjera në fushën e falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë, të dokumenteve, e të tjerë.

Po kështu, është treguar shumë kujdes që të mos përfitojnë nga amnistia disa vepra veçanërisht të rënda, siç janë krimet kundër autoritetit të shtetit, veprat kundër drejtësisë, ato që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve e të tjerë.

Ndërkohë, një ndër risitë që shoqëron projektligjin në fjalë konsiston, pikërisht, në parashikimin e lehtësirave në kuadër të përcaktimit të kriterëve për përfitimin e amnistisë për shtetasit e mitur dhe femra. Për këtë qëllim, nisur edhe nga situata faktike e gjendjes së të dënuarave në IEVP-në përkatëse, kriteret për përfitimin nga amnistia të këtyre dy kategorive janë përcaktuar në mënyrë të kujdesshme, pas një analize të plotë të veprave penale për të cilat janë dënuar,

duke u krijuar lehtësira me qëllim përfitimin nga amnistia që propozohet. Sigurisht që është treguar kujdes për përcaktimin e kriterëve ndaluesë të përfitimit, vetëm në atë masë dhe për ato lloje veprash penale për të cilat ka një shkallë të lartë rrezikshmërie dhe për të cilat edhe ashpërsia e dënimit të dhënë është më e madhe.

Konkretisht, në kuadër të arritjes së qëllimit të synuar, në drejtim të minimizimit të pengesave ligjore ndaj kategorisë së sipërcituar të të dënuarve, si dhe duke pasur në konsideratë kushtet psiko-sociale veçanërisht të dallueshme të kësaj kategorie, në raport me të dënuarit e tjerë, nëpërmjet projektligjit në fjalë, rregullohet:

- mosparashikimi për subjektet e dënuara femra, të mitur dhe subjektet e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, si pengesë ligjore për përfitimin e amnistisë të disa prej neneve apo kategorive të veprave penale të cilat parashikohen si të tilla për subjektet e dënuara, meshkuj, të cilët kanë qenë apo janë madhorë, në kohën e ekzekutimit të dënimit apo në atë të kryerjes së veprës penale;
- përcaktimi si kriter ndalues i faktit të të qenit recidivistë për të njëjtën vepër penale, vetëm për të dënuarit meshkuj (persona madhorë).

Përcaktimi i kriterëve lehtësuesë për përfitimin nga amnistia, për të miturit dhe gratë, bëhet jo vetëm nisur nga qëllimet e humanizmit dhe të ofrimit të mbështetjes më të lartë për këtë kategori, por edhe sepse, për shkak të pozitës më vulnerabël në shoqëri, pavarësisht se janë ndëshkuar si autorë, në fakt kanë qenë dhe vetë viktimat të veprave penale, duke u përdorur nga elementet kriminale. Për këtë arsye, meritojnë një mundësi më shumë për një riintegrim më të shpejtë. Është e pamohueshme nevoja që gratë dhe të miturit të kenë në shoqërinë tonë një përqasje më specifike, përfshirë përqasjen e diferencuar sa i përket përfitimit nga amnistia, ashtu si një përqasje ndryshe në përcaktimin e masës së dënimit, si dhe dhënien e mundësive specifike mbështetëse për të ecur përpara.

Është fakt, gjithashtu, që gratë e dënuara veçohen nga familjet e tyre, kanë më pak vizita dhe kjo prek ndjeshëm aftësinë e tyre për të ruajtur marrëdhëniet dhe kontaktet familjare. Kjo kategori (duke mbajtur në konsideratë dhe veprat penale të kryera, njëkohësisht me rrethanat specifike që i kanë çuar në kryerjen e tyre), në momentin e lirit, përballen me vështirësi në akomodim, punësim, nxjerrje të ardhurash dhe përkujdesje ndaj fëmijëve të tyre. Ndaj kjo amnisti është një hap i parë në serinë e përpjekjeve për t'i mbështetur, duke lehtësuar riintegrimin.

Sjellim në vëmendje se struktura e projektligjit është e ngjashme me strukturat e ligjeve të viteve 2014, 2015 dhe 2016, që kanë të njëjtin objekt rregullimi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Kjo nismë është e mbështetur në pikat 1 dhe 2, shkronja “ë”, të nenit 81, të Kushtetutës, si dhe bazohet në parashikimet e nenit 71, të Kodit Penal, ku parashikohet, ndër të tjerash, se, Kuvendi, me aktin e amnistisë përjashton nga vuajtja e dënimit, tërësisht apo pjesërisht, ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë.

Referuar parashikimeve të projektligjit në fjalë, aministia do t’i shtrijë efektet përkatëse për dënime të dhëna deri në datën 30.9.2019.

Për më tepër që nisma ligjore për amnistinë është shumë e rëndësishme në drejtim të menaxhimit të drejtë të fondeve buxhetore, të funksionimit brenda standardeve të sistemit të burgjeve në përgjithësi, pritshmërive pozitive të individit të një shteti human, si dhe të respektimit të të drejtave themelore të njeriut.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së, ndaj edhe nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban dispozitën e qëllimit dhe parimet që udhëheqin zbatimin e tij.

Në nenin 1 parashikohet se qëllimi i tij është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të ligjit.

Gjithashtu, dhënia e amnistisë udhëhiqet nga parimet e humanizmit, arritjes së qëllimit të dënimit, edukimit dhe rehabilitimit, rrezikshmërisë së ulët të personave që amnistohen, mbrojtjes së interesit publik, si dhe dhënies së mundësisë së integritetit më lehtë dhe më shpejtë të të dënuarve.

Për zbatimin me korrektësi të projektligjit dhe shmangies së mundësisë së interpretimeve të ndryshme, nëpërmjet nenit 2, të projektligjit, përcaktohen përkufizimet lidhur me terminologjinë e përdorur në të, përkatësisht, për termin “i dënuar” dhe “person që i është shmangur drejtësisë”.

Lidhur me këtë aspekt vlen të theksohet, gjithashtu, se, në funksion të harmonizimit të dispozitave të projektligjit objekt shqyrtimi, me ndryshimet përkatëse ligjore që ka pësuar së fundi Kodi i Procedurës Penale, nëpërmjet ligjit nr.35/2017, që ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017, në nënndarjet “iii” dhe “iv”, të shkronjës “a”, të nenit të sipërcituar, është parashikuar shtrirja e efekteve të këtij projektligji edhe në rastet kur Gjykata e Lartë ka ushtruar juridiksionin respektiv, sipas parashikimeve të mëparshme ligjore të Kodit të Procedurës Penale, në drejtim të gjykimit në themel të çështjeve apo të gjykimit të tyre si gjykatën e shkallës së parë.

Në nenin 3 parashikohen kriteret për përfitimin e amnistisë, sipas të cilave përfshihen subjektet, si më poshtë:

- personat meshkuj, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna me vendim gjyqësor deri në datën 30.9.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
- personat femra dhe të mitur, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 30.09.2019, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;
- personat meshkuj, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij projektligji, u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 vjet;
- personat femra dhe të mitur, dënuar me burgim, të cilëve, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij projektligji, u kanë mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet;
- personat e dënuar femra, të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 50 vjeç;
- personat e dënuar meshkuj, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë baras ose mbi moshën 60 vjeç;
- personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

Më tej, ky nen parashikon si rast përjashtimor, për të dënuarat dhe të miturit, të cilët nuk plotësojnë kriteret për të përfituar amnisti, sipas pikave 2, 4, 5 dhe 7, të tij, zbritjen me 1/3 (një të tretën) e dënimit të mbetur, pavarësisht kriterëve të tjera ndaluese të parashikuara në projektligj. Një parashikim i tillë, vetëm për këtë kategori subjektsh, është bërë me qëllim dhënien e mundësisë së integritit më të lehtë dhe më të shpejtë të tyre.

Në nenin 4 parashikohen kriteret të posaçme ndaluese për përfitimin e

amnistisë, për secilën kategori subjektësh, ku ndër të tjera:

a) të dënuarit meshkuj (personat madhorë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe vuajtjes së dënimit) nuk përfitojnë nga amnistia në rast se janë dënuar për disa prej veprave penale të kategorive të mëposhtme:

- Krime kundër njerëzimit;
- Krime kundër jetës, të kryera me dashje;
- Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit;
- Krime seksuale;
- Vepra penale kundër lirisë së personit;
- Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit;
- Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes;
- Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- Vepra penale kundër falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë;
- Vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve;
- Vepra penale kundër zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit;
- Veprat penale që çenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve;
- Vepra penale kundër mjedisit;
- Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- Krime që çenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera;
- Vepra me qëllime terroriste;
- Krime kundër autoritetit të shtetit;
- Vepra penale kundër drejtësisë;
- Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;
- Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale.

b) të dënuarat femra, të miturit dhe subjektet që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur, nuk përfitojnë për shkak amnistie në rast se janë dënuar për disa prej veprave penale, të kategorive të mëposhtme:

- Krime kundër njerëzimit;
- Krime kundër jetës;
- Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit;
- Krime seksuale;
- Vepra penale kundër lirisë së personit;
- Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes;
- Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues;
- Krime që çenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera;
- Vepra me qëllime terroriste;
- Krime kundër autoritetit të shtetit;

- Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale.

Ndërkohë që pika 3, e nenit të sipërcituar, përcakton ndalimin absolut për të përfituar nga amnistia, në rastet kur subjektet përkatëse i janë shmangur drejtësisë, ndërsa pika 4 e po këtij neni ndalon përfitimin e amnistisë për të dënuarit meshkuj, në rast se janë përsëritës të së njëjtës vepër penale.

Sjellim në vëmendje se, sikurse është cituar edhe në pjesët pararendëse të këtij relacioni, kryerja e një rregullimi të tillë, përmes dispozitës në fjalë, bëhet duke pasur veçanërisht në konsideratë nevojat që lidhen me:

- kushtet personale, familjare, sociale, të të dënuarave femra, të miturve dhe subjekteve që në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë të mitur, në tërësi;
- moshën, arsimimin apo nevoja të tjera të të miturit, në veçanti.

Në nenin 5 parashikohet se nga zbatimi i projektligjit në fjalë nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit, deri në momentin e hyrjes në fuqi të projektligjit. Një parashikim i tillë është bërë duke pasur si qëllim ruajtjen e balancës ndërmjet të drejtave të të pandehurit nga njëra anë dhe të drejtave të viktimës nga ana tjetër, figura e së cilës është elaboruar gjerësisht me ndryshimet e fundit që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale.

Neni 6 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit, 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar me kontribut të grupit të punës, ngritur me urdhrin nr.9526, datë 18.9.2018, të ministrit të Drejtësisë, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për dhënie amnistie””.

Projektligji i është nënshtruar një procesi konsultimi paraprak me institucionet ligjzbatuese.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE